VENDIM
Nr. 42, datë 6.3.2020

MBI KËRKESËN E SHOQËRISË "ELECTRAL BATRA HPP" SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC "SELITA", ME KAPACITET TË INSTALUAR 1798 kw; HEC "FRANKTHI", 2129 kw DHE HEC "BATRA", 2411 kw, ME KAPACITET TOTAL TË INSTALUAR 6338 kw

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa "a", nenit 5, pika 1, germa "a" dhe nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar, dhe nenit 15 të "Rregullores të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 6.3.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 30/11 prot., datë 21.2.2020, mbi licencimin e shoqërisë "Electral Batra HPP" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- ERE, me vendimin nr. 135, datë 6.9.2019, filloi procedurën për licencimin e shoqërisë "Electral Batra HPP" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje u krye njoftimi në medien e shkruar me shkresën nr. 32/41, datë 6.9.2019, dhe në përfundim të afatit të përcaktuar në nenin 10, pika 11, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", nuk rezultoi të ketë vërejtje apo ankesa nga palët e treta, lidhur me aplikimin e bërë nga shoqëria "Electral Batra HPP" sh.p.k.

- Në vijim, ERE iu drejtua shoqërisë me shkresat nr. 510/1 prot., datë 11.9.2019, dhe 510/4 prot., datë 13.11.2019, me anë të të cilave i bëri me dije fillimin e procedurës dhe i drejtoi kërkesat për plotësimin e dokumentacionit të munguar.

- Në përgjigje të sa më sipër, shoqëria "Electral Batra HPP" sh.p.k., me shkresat e protokolluar në ERE me nr. 510/3, datë 21.10.2019, nr. 23 prot., datë 9.1.2020, dhe nr. 135 prot. i ERE-s, datë 24.1.2020, ka plotësuar dokumentacionin e munguar.

- Shoqëria "Electral Batra HPP" sh.p.k. është një subjekt tregtar i krijuar si detyrim ligjor i nenit 8 të Kontratës Koncesionare të formës BOT, me nr. 3393 rep. dhe nr. 1231 kol., datë 20.12.2016, "Për ndërtimin e HEC-eve 'Batra' nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3", të lidhur ndërmjet Bashkimit të Përkohshëm të shoqërisë "Electral" sh.p.k. me "ALBAVIA" sh.p.k. në cilësinë e Koncesionarit dhe Autoritetit Kontraktues, Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë (sot "MIE"), në zbatim të VKM-së nr. 623, datë 7.9.2011 "Për përcaktimin e autoritetit kontraktues dhe dhënien me koncesion të HEC-eve 'Batra' nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3 dhe miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese që i jepet shoqërisë". Kjo shoqëri, është regjistruar në QKB, në datën 23.12.2016, konform ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

- Shoqëria ka depozituar në ERE edhe kontratën shtesë të koncesionit me nr. 813 rep., nr. 273 kol., datë 6.9.2017, "Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës "BOT", për ndërtimin e HEC-eve 'Batra' nr. 1, nr. 2 dhe nr. 3".

- Shoqëria "Electral Batra HPP" sh.p.k. ka depozituar në ERE certifikatat për vërtetim titulli "Në përdorim", për pronësitë ku do të shtrihet projekti i HEC-eve në zonat kadastrale me nr. 1325 dhe nr. 1626, të rrethit Mat, të lëshuara nga ZVRPP Mat për shoqërinë "Electral" dhe shoqërinë "Albavia", në cilësinë e aksionarëve të shoqërisë koncesionare "Electral Batra HPP" sh.p.k. dhe

Bashkimit të përkohshëm të shoqërive që kanë lidhur kontratën e koncesionit me MIE. Këto certifikata janë të shoqëruara me hartën treguese të regjistrimit dhe kartelat e pasurisë së paluajtshme nga të cilat rezulton se prona që jepet në përdorim është në pronësi të shtetit.

- Shoqëria ka depozituar në ERE, Oponencën Teknike të kryer nga AKBN-ja nr. 1789/1 prot., datë 13.6.2017, mbi projektin e zbatimit të HEC-eve "Selitë", "Frankth" dhe "Batra". Grupi i Oponencës Teknike ka konkluduar se projekti i zbatimit për kaskadën e HEC-eve "Batra", "Frankth" dhe "Selitë", plotëson kushtet teknike dhe standardet e projektimit për fazën e ndërtimit të veprës hidroenergjetike.

- Shoqëria ka depozituar në ERE deklaratën mjedisore me nr. 10827/1 prot., datë 19.12.2019, me nr. identifikimi 1171 dhe nr. vendimi 65. Kjo deklaratë mjedisore lëshohet për shoqërinë "Electral Batra HPP" sh.p.k., për "Ndërtimin e hidrocentraleve 'Batër', 'Frankth', 'Selitë"', me vendndodhje në pellgun e Përroit të Zallit të Batrës, Bashkia Mat, qarku Dibër, për kapacitetin e instaluar 6338 kw. Sa i përket afatit kohor të vlefshmërisë së deklaratës mjedisore shprehet se: "Nëse veprimtaria nuk fillon zbatimin në terren brenda dy viteve nga data e miratimit të vendimit për VNM-në, atëherë këto dokumente konsiderohen të pavlefshme dhe procesi i VNM-së fillon nga e para".

- Për gjithë sa më sipër, konkludojmë se rezultojnë të paplotësuara apo plotësuar pjesërisht dokumentet, si më poshtë:

- Dokumentacioni teknik për HEC.

- Neni 9, pika 4.1.1, të dhëna specifike për HEC.

- Neni 9, pika 4.1.2, të dhëna për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin

- Sipas nenit 10 "Programi i punimeve" të kontratës së koncesionit, koncesionari merr përsipër të fillojë punimet në zbatim të projektit brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të lejes së ndërtimit. Koncesionari merr përsipër të vërë në punë HEC-in brenda 12 muajve nga data e marrjes së lejes së ndërtimit.

- Për HEC "Selita", HEC "Batra" dhe HEC "Frankthi": për çdo njërën prej tyre mungojnë ende të dhënat për tensionin në dalje të gjeneratorit; n/st. ku lidhet; tensioni i rrjetit të shpërndarjes/transmetimit ku lidhet centrali; rendimenti; pengesë për plotësimin e këtij kushti është bërë refuzimi i OST sh.a., për lidhjen me rrjetin e transmetimit, pavarësisht se ERE ka pasur një sërë komunikimesh me OST sh.a., së fundmi me shkresën nr. 589/4 prot., datë 15.11.2019, sa i përket problematikës së pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit. OST sh.a., me shkresën e tij të fundit nr. 589/5 prot., datë 23.12.2019, vijon të mbajë të njëjtin qëndrim duke sugjeruar një zgjidhje alternative, për lidhjen e shoqërisë "Electral Batra HPP" sh.p.k., në nënstacionin e një shoqërie private, i cili nuk është në pronësi të OST sh.a. Në nenin 29, të ligjit nr. 43/3015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar parashikohet se "Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes garantojnë aksesin në rrjet për të gjithë klientët dhe përdoruesit e sistemit, mbi baza transparente, jodiskriminuese dhe bazuar në tarifat e miratuara dhe të publikuara nga ERE. Prodhuesit, që prodhojnë energji nga burime të rinovueshme, kanë përparësi në aksesin në rrjetet elektrike". Sa më sipër, rezulton se për kushtet që lidhen me të dhënat e gjeneruara pas miratimit të pikës së lidhjes, përmbushjen e së cilës e garanton ligji dhe e mundësojnë operatorët përgjegjës të sistemit, aplikuesi ka marrë të gjithë hapat e nevojshëm për plotësimin e tyre.

- Dokumentacioni teknik-ekonomik.

- Neni 9, pika 4.1.4, germa "a": studimi i fizibilitetit. Në ERE nuk është depozituar një kopje e studimit të fizibilitetit të cilin shoqëria ka depozituar në MIE para marrjes së miratimit dhe nënshkrimit të kontratës së koncesionit me Autoritetin Shtetëror.

- Leje nga institucione të tjera.

- Miratimin e OST-së ose OSSH-së për lidhjen e centralit në rrjetin elektrik të transmetimit ose shpërndarjes. Rezulton se për kushtin që lidhet me miratimin e pikës së lidhjes, përmbushjen e së

cilës e garanton ligji dhe e mundësojnë operatorët përgjegjës të sistemit, aplikuesi ka marrë të gjithë hapat e nevojshëm për plotësimin e tyre, dhe mbështetur në nenin 29, të ligjit nr. 43/3015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar, janë operatorët e sistemit përgjegjës për garantimin e aksesit.

- Leja e përdorimit të ujit për prodhimin e energjisë elektrike: pa plotësuar.
- Nga analiza e dokumentacionit të depozituar në ERE nga shoqëria "Electral Batra HPP" sh.p.k., rezulton se subjekti ka plotësuar pjesërisht kërkesat e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, si më poshtë:
- Formati dhe dokumentacioni për aplikim. Neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c": plotësuar.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor. Neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g": plotësuar.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal. Neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c", "d": plotësuar.
- Dokumentacioni teknik për HEC-in. Neni 9, pikat 4.1.1; 4.1.2; 4.1.3, germat "a", "b", "c", "d" dhe pika 4.1.4, germat "a", "b", "c", "d", "e": plotësuar pjesërisht.
- Leje nga institucione të tjera. Neni 9, pika 4.1.5, germat "a", "b", "c": plotësuar pjesërisht.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Electral Batra HPP" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Selita" me kapacitet të instaluar 1798 kw, HEC "Frankthi" 2129 kw dhe HEC "Batra" 2411 kw, me kapacitet total të instaluar 6338 kw, për një afat 30-vjeçar, me kusht që përpara fillimit të operimit të depozitojë në ERE:
   - Miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin elektroenergjetik.
   - Dokumentacioni teknik për HEC-et.
   - Lejen e shfrytëzimit të ujit.
   - Studimin e fizibilitetit.
2. Mosplotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti